



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DORËZIM - PRILJENO - RECEIVED			
Nësi org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	50/34	2



## Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

### Ndërmjet

**SWISSCONTACT** - financuar nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim në Kosovë/projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PSPE), përfaqësuar nga z. Fisnik Reçica, Menaxher i Projektit.

dhe

**KOMUNËS SË SUHAREKËS** - përfaqësuar nga z. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës.

### Neni 1

### QËLLIMI

**Komuna e Suharekës dhe Swisscontact** – Projekti për Promovimin e Punësimit në Sektorin Privat – PPSE lidhin këtë memorandum mirëkuptimi, me qëllim të bashkëfinancimit për avancim dhe modernizim të fidanishteve për prodhimin e fidaneve të perimeve në komunën e Suharekës, specifikisht për fermerin Besar Kryeziu (Bes Jet SHPK).

Qëllimi kryesor është që në komunën e Suharekës të prodhohen fidane cilësore në kushte moderne, që fermerët tjerë të kenë qasje në blerjen e fidanëve cilësorë, gjë e cila më pas siguron kualitet dhe rendiment më të lartë të prodhimeve bujqësore. Përmes modernizimit të fidanishtes për prodhimin e fidaneve të perimeve synohet rritja e kualitetit dhe rendimentit të perimeve të kultivuara, zgjerimi i sipërfaqeve të kultivuara, përfshirja e fermerëve tjerë në përdorimin e fidaneve kualitative dhe që gjithë kjo rezultojnë në punësim shtesë dhe rritje të të hyrave në gjithë zinxhirin, nga fermeri deri në tregun final.

Gjithashtu, komuna e Suharekës dhe Swisscontact përmes këtij memorandumimi do të shqyrtojnë edhe mundësi të tjera bashkëpunimi.



## Neni 2

### VEPRIMET E KOMUNËS SË SUHAREKËS

Komuna e Suharekës do të angazhohet për:

- a) Bashkëpunim me Projektin PPSE për bashkëfinansim në ndërtimin e fidanishtes Bes Jet SHPK të përfaqësuar nga Besar Kryeziu.
- b) Komuna e Suharekës do të ndajë buxhetin në vlerë maksimale prej 10,000.00 € (~10% të vlerës totale të investimit) për zbatimin e aktiviteteve dhe investimeve të parashikuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.
- c) Komuna e Suharekës do t'i transferojë këto mjete prej 10,000.00 € në llogarinë e mëposhtme:

Bank name: ProCredit Bank Kosovo

Account name: SWISSCONTACT NGO

Account number: 1110118206020190

Mjetet e zotuar nga Komuna e Suharekës do të transferohen në llogarinë e lartpërmendur në një afat optimal por jo me larg se data 31.01.2023 pas nënshkrimit të këtij memorandumi.

## Neni 3

### VEPRIMET E SWISSCONTACT / PPSE:

- a) Siguron realizimin e planit investiv të hartuar në konsultim të afërt me ekspertin e fushës (të angashuar nga PPSE) dhe Fidanishtja Bes Jet SHPK përfaqësuar nga Besar Kryeziu.
- b) Merr përsipër të gjitha procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e furnitorëve për pajisjet e nevojshme për ndërtimin e fidanishtes Bes Jet SHPK përfaqësuar nga Besar Kryeziu.
- c) Siguron buxhetin dhe ekzekuton pagesat deri në vlerën maksimale **37,337.80 €**, si bashkëfinancues për investimet në fidanishte.
- d) Ekzekuton pagesën në vlerë maksimale deri në **10,000.00 €** nga kontributi buxhetor i Komunës së Suharekës, tek palët e treta si furnitorë të pajisjeve për fidanishten.
- e) Monitoron investimin nga ana e fidanishtes Bes Jet SHPK përfaqësuar nga Besar Kryeziu në vlerë jo me të vogël se **57,658.50 €** si vet-investim i fermerit.



Neni 4

## RAPORTI FINANCIAR

Bashkëfinancimi i palëve të cekura më lartë, është i specifikuar në tabelën më poshtë:

Buxheti i vlerësuar per fidanishten "Bes-Jet"							Kontributi (€)		
#	Aktiviteti	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Buxheti total	PPSE	Bes_Jet	Komuna e Suharekes
<b>1</b>	<b>Konstruksioni I serres</b>								
1.1	Konstruksioni I serres per fidanishten	Dy tunele me nga 7 metra gjeresi dhe 109 metra gjatesi, ne total 15.26 ari. Sera do jete me hapje lart vetem ne nje krah nga lindja	Lump sum	1	€ 30,000.0	€ 30,000.0	€ -	€ 30,000.0	€ -
<b>2</b>	<b>Betonimi I rrugicave dhe vendosja e bezes kundër barërave të këqija</b>								
2.1	Betonimi i rrugicave	Betonizimi i rrugicave sipas skemes	m3	20	€ 60.0	€ 1,200.0	€ -	€ 1,200.0	€ -
2.2	Rrjeta per beton8 (7.5)	Rrjeta per betonim te rrugicave (nje cope eshte me dimensione 12m2). Ne total nevojiten200m2	cope	17	€ 46.00	€ 782.0	€ -	€ 782.0	€ -
2.3	Beza	Beza kunder lageshtise dhe barerave te keqia	m2	1,200	€ 0.65	€ 780.0	€ -	€ 780.0	€ -
2.4	Rrjeti anti-insekt (anti-trips)	Rrjeta anti trips	m2	450.0	€ 0.75	€ 337.5	€ -	€ 337.5	€ -
<b>3</b>	<b>Punimi dhe montimi i tavolinave</b>								
3.1	Profile ne forme T	Profile T me gjatesi 295cm. Bazamenti (pjesa horizontale) ne te dy anet duhet te jete nga 3cm ndersa lartesia (pjesa vertikale) 4 cm. Trashesia e llamarines duhet te jete 2 mm	cope	784	€ 16.6	€ 13,045.8	€ 13,045.8	€ -	€ -
3.2	Profile te zinkuara	Profile te zinkuara 4cm x 3cm dhe trashesi 2mm. Gjatesia mund te jete 6 metra.	ml	420	€ 4.9	€ 2,058.0	€ 2,058.0	€ -	€ -
3.3	Bazamenti tavolinave	156 copa me permasa 223 cm gjatesi dhe dy kembeza me 80cm lartesi dhe saldimi ne 40cm nga skajet. Permasat e profilit: 4x3x2	cope	156	€ 28.5	€ 4,446.0	€ 4,446.0	€ -	€ -
3.4	Montimi i tavolinave	Montimi i tavolinave pas betonimit te kembezave	lump sum	1	€ 980.0	€ 980.0	€ 980.0	€ -	€ -
<b>4</b>	<b>Sistemi I ngrohjes dhe ventilimi</b>								
4.1	Sistemi I ngrohjes	Kaldaje me bersi ulliri (Kaldaja me kapacitet 280 mije k/kalori/ore)	Lump sum	1	€ 10,000.0	€ 10,000.0	€ -	€ -	€ 10,000.0
4.2	Sistemi i ventilimit	Ventilator dhe pajisje per ajrosjen e serres	cope	10	€ 400.0	€ 4,000.0	€ -	€ 4,000.0	€ -
<b>5</b>	<b>Sistemi boom i ujtjes dhe termoscreen</b>								
5.1	Sistemi boom i ujtjes	Me cift sprucatoresh (fertigim dhe trajtim gjethor). Per 2 tunele, secili me gjatesi 105 m x 7 m gjeresi.	cope	2	€ 5,054.0	€ 10,108.0	€ 10,108.0	€ -	€ -
5.2	Transporti	Transporti nga vendi i origjines	Lump sum	1	€ 600.0	€ 600.0		€ 600.0	
5.3	Instalimi	Instalimi nga ekspertat e kompanise prodhuese	Lump sum	1	€ 2,700.0	€ 2,700.0	€ 2,700.0	€ -	€ -
5.4	Termoscreen		m2	1,550	€ 7.0	€ 10,850.0	€ -	€ 10,850.0	€ -
5.5	Transporti	Shpenzimet e transportit per sistemin boom	Lump sum	1	€ 2,000.0	€ 2,000.0	€ -	€ 2,000.0	€ -
5.6	Instalimi	Shpenzimet e montimit per termoscreen nga ekspertet	cope	1	€ 3,500.0	€ 3,500.0	€ -	€ 3,500.0	€ -
<b>6</b>	<b>Dhoma e mbirjes dhe karrocet</b>								
6.1	Dhoma e mbirjes	Dhoma e mbirjes (4x3x2.6) me panele me trashesi 10cm me paisjet per ngrohje dhe prodhim te lageshtise.	cope	1	€ 4,000.0	€ 4,000.0	€ 4,000.0	€ -	€ -
6.2	Karrocet per vendosjen e moduleve	Materiali per punimin e karrocave (L profile te gatshme 16 cope x198 cm me permasa 4x3x2mm ne total 32 ml) dhe profil i zinguar 4x4x2 ne total 12ml; rrotat me levizje majtas-djathtas dhe frenat; saldimi dhe montimi)	cope	2	€ 318.0	€ 636.0	€ -	€ 636.0	€ -
6.3	Materiale dhe pune tjera	Shtirija dhe rrafshimi i zhavorit dhe punime tjera per rregullimin e fidanishtes	lump sum	1	€ 3,000.0	€ 3,000.0		€ 3,000.0	€ -
<b>Total</b>						<b>€ 105,023.3</b>	<b>€ 37,337.8</b>	<b>€ 57,685.5</b>	<b>€ 10,000.0</b>
						<b>100%</b>	<b>35.55%</b>	<b>54.93%</b>	<b>9.52%</b>

\*Çdo ndryshim eventual i vlerës totale të investimit, si rezultat i lëvizjes së çmimeve të tregut, do të mbulohen nga Swisscontact dhe fidanishtja Bes Jet SHPK përfaqësuar nga Besar Kryeziu, dhe nuk do të ndikoj në vlerën e kontributit të Komunës së Subarekës në vlerë totale prej 10,000.00 €.



## Neni 5

5.1 Gjatë realizimit të projektit të cekur në Nenin -1- të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëfinancim, nga organi mbikqyrës i Komunës të cilin do të caktojë Komuna e Suharekës, gjegjësisht Kryetari dhe përfaqësuesit e Swisscontact, do të përgatitin raport me shkrim për Komunën e Suharekës në periudhën e fillimit të zbatimit si dhe përmbylljen e projektit duke prezantuar deftesa, përkatësisht fletëpagesa në pajtueshmëri me Rregulloren financiare Nr-01/2013, nga Ministria e Financave për shpenzimin e parasë publike.

## Neni 6

### KOORDINIMI DHE KONSULTIMET

- a) Palët pajtohen që gjatë implementimit të kësaj marrëveshje, do të shkëmbejnë informacione dhe do të takohen sipas nevojës për të vlerësuar dinamikën e implementimit të marrëveshjes dhe efektivitetin e mbështetjes.
- b) Çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me administrimin dhe implementimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit do të zgjidhet nëpërmjet konsultave të palëve në fjalë.
- c) Nëse palët nuk mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet sipas pikës b) të këtij neni kompetent për këtë do të jetë gjykata kompetente.

## Neni 7

### DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

- a) Amandamenti apo shkëputja e marrëveshjes: Palët kanë të drejtë të amandamentojnë apo shkëpusin pjesëmarrjen në marrëveshje duke dërguar paralajmërim me shkrim 15 ditë më herët.
- b) Data e hyrjes në fuqi dhe kohëzgjatja: Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët me kohëzgjatje deri më 15 dhjetor, 2023.
- c) Përfaqësimi: Palët do të përfaqësohen nga personat e mandatuar nga nënshkruesit e marrëveshjes.
- d) Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
- e) Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshje, do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.



**Neni 8**

**HYRJA NË FUQI**

Ky Memorandum Mirëkuptimi është i hartuar në dy kopje identike dhe i përpiluar në dy gjuhë (anglisht dhe shqip) hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e të dy palëve.

**KOMUNA E SUHAREKËS**  
**Bali Muharremaj, Kryetar**



**SWISSCONTACT**  
**Fisnik Reçica, Menaxher i Projektit**